



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068:

## KOPSHTI PARASHKOLLOR “SHTËPIA MAGJIKE” SHPALL

# KONKURS

### PËR KËTO VENDE TË LIRA TË PUNËS:

Niveli	Institucioni	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Kodi i pozitës	Vendi i lirë/ Zëvendësim
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	01	Vendi i lirë
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	02	Vendi i lirë
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	03	Vendi i lirë
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	04	Vendi i lirë
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	05	Vendi i lirë
IP	Shtëpia Magjike	Besi	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	06	Vendi i lirë

### Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri**. Diploma ose certifikata duhet te përcaktoj qartë notën mesatare.

#### **Dëshmi shtesë për fazës paraseleksionuese :**

- Çertifikatat e trajnimeve te akredituara nga MASHT, gjegjësisht **vetëm ato që konsiderohen relevante për nivelin e arsimit përkatës nga ana e institucionit**.

- Dëshmi të përvojës së punës vetëm në institucione arsimore (**vetëm kontrata ose vërtetimi i nga ana e punëdhënësit që përcakton qartë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës do të merren parasysh**).

#### **Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës (UA Nr. 09/2014). **Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim.**

#### **Sqarime shtesë:**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

**Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).**

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Me rastin e marrjes së aplikacionit, kandidatët mund të marrin edhe dokumentin ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes dhe dokumentin ku përshkruhen kriteret e paraseleksionimit.

Për intervistë do të ftohet 3-5 kandidatët që i plotësojnë më së miri kushtet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Përzgjedhja për intervistë do të bëhet bazuar në kualifikimet formale adekuate, përvojën e punës relevante në arsim, trajnimet e përfunduara relevante të akredituara nga MASHT dhe notën mesatare gjatë studimeve.

**Shenim:** master i papërfunduar duhet të sillen certifikata e notave (origjinale).

Nëse i njëjti person aplikon në më shumë se një pozitë/institucion, atëherë për secilën pozitë/institucion duhet të dorëzojë aplikacionin e veçantë të kompletuar. Por, nëse kandidati i plotëson kushtet për t'u ftuar në intervistë, mund të ftohet në intervistë vetëm në një institucion, përkatësisht vetëm për një pozitë.

**Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **11.08.2015** gjer më datën **28.08.2015**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.